

Njoftim mbi të drejtat e subjektit të të dhënave personale gjatë procesit të rekrutimit

Të gjitha të dhënat personale që subjekti i të dhënave/kandidati i deklaron me qëllim të procesimit të aplikimit për punë, do të ruhen me qëllim që Kreditimi Rural i Kosovës të shqyrtoj aplikimin për punë të subjektit të të dhënave, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

Të dhënat personale të kandidateve që aplikojnë për punë, KRK i ruan/mbanë për një periudhë e cila është në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, dhe më pas ato fshihen apo bëhen anonime, nëse kjo nuk është e mundur atëherë ato izoloohen derisa fshirja të jetë e mundur.

Të drejtat e subjektit të të dhënave personale

Si subjekt i të dhënave, ju keni të drejtat e mëposhtme në lidhje me të dhënat tuaja personale:

- **E drejta e informimit** – Ju keni të drejtë të informoheni se si KRK përpunon të dhënat gjatë procesit të rekrutimit;
- **E drejta e qasjes**– Ju keni të drejtën të merrni konfirmimin nga KRK, nëse po përpunohen ose jo të dhënat që kanë të bëjnë qëllimin e përpunimit të tyre .
- **E drejta për korrigjimin e të dhënave:** Ju keni të drejtë të korrigjoni të dhënat tuaja nëse janë të pasakta ose jo të plota. Korrigjimi mund të bëhet pas kërkesës suaj drejtuar KRK-së, në afatin e paraparë ligjorë.
- **E drejta për fshirjen e të dhënave:** Ju keni të drejtë të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja personale, nëse nuk ka baza ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja personale ose bazat ligjore kanë pushuar së ekzistuar. KRK, do ju komunikojë për çdo korrigjim, fshirje apo kufizim të përpunimit të kryer, sipas dispozitave ligjore.
- **E drejta për të kufizuar përpunimin** - Ju keni të drejtë të kërkonti kufizim të përpunimit të të dhënave tuaja personale nëse kundërshtoni mënyrën e përpunimit të tyre;
- **E drejta për vendimmarrjen e automatizuar individuale, duke përfshirë profilizimin:** Ju keni të drejtë të mos i nënshtroheni një vendimi të bazuar vetëm në një përpunim automatik, duke përfshirë profilizimin që prodhon efekte në lidhje me të ose e ndikon në mënyrë të ngjashme atë.
- **E drejta e tërheqjes së pëlqimit:** Ju keni të drejtë të tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë, duke plotësuar [Formularin e Tërheqjes së Pëlqimit](#). Pas plotësimit të formës, ju duhet ta dërgoni në e-mail adresën mbrojtja_etëdhënave@krk-ks.com, gjithashtu dërgimi i tij mund të bëhet fizikisht ose përmes postes në degën respektive të KRK-së.

Ne ofrojmë mbrojtjen e nevojshme dhe të arsyeshme për ruajtjen e intimitetit, sigurisë dhe integritetit të të dhënave tuaja personale. Andaj për informacione të mëtejshme se si përpunohen të dhënat tuaja personale, të gjitha detyrimet e tjera të kontrolluesit, si dhe të gjitha të drejtat tuaja të tjera në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, mund të kontakoni në e-mail adresën e mësipërme ose në numrin e telefonit +383 38 222 345.